

P.nr. 241/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm , Gjyqtarja **Ilirjana Hoti** , me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. Q. nga Gjakova, për shkak se si bashkkryes ka kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë në vazhdimësi nga neni 253par. 1-1- 23 të KPK-së lidhur me nenin 81.të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore -DP në Gjakovë, PP.nr.731/12 dt.22.02.2013 , në shqyrtimin publik gjyqësor, të mbajtur më datë **18.01.2017**, në prani të Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu dhe te akuzuarit B. Q., mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **B. Q.**, i lindur me dt... ne Gjakovë ,me banim ne Rr..., i biri i Q. dhe i nënës Sh. e gjinisë Rr., ka te kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes se varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i R.Kosovës , i martuar .

Ë s h t ë f a j t o r**Sepse :**

-me qëllim qe vetit ti sjellin përfitim pasuror te kundërligjshëm, me **dt. 19.11.2012** , rreth orës 01:00 min, pasi me pare janë marr vesh mes veti dhe i kanë ndarë rolet me qëllim vjedhje, kanë shkuar ne rrugën "S.Pozhegu" ne Gjakovë, dhe pasi me pare me anë te një çelësi për montimin e një rrote te automjetit e kanë thyer xhamin e fundit te majtë te automjetit te tipit "Passat" ne targ. Te regj..., pronë e te dëmtuarit M. V. dhe nga automjeti kanë vjedhë një çantë dore femrash dhe kanë ikur ne drejtim te panjohur.

-me qëllim qe vetit ti sjellin përfitim pasuror te kundërligjshëm, me **dt.19.11.2012**, rreth orës 01:30 min, pasi me pare janë marr vesh mes veti dhe i kanë ndarë rolet me qëllim vjedhje kanë shkuar ne rrugën "L.Gurakuqi" , në Gjakovë, dhe pasi me parë kanë hequr tjegullat e çatisë se dyqanit DPT "K.", pronë e te dëmtuarit V. M., kanë depërtuar brenda dhe kanë vjedhur 20 boksa duhan te llojeve te ndryshëm si:4 boksa "Lucky" ne vlere prej 60 euro, 2 boksa "Winston" ne vlere 24 euro, 2 boksa "Ronhill" ne vlere 22 euro, 2 boksa "Eva " ne vlere 22 euro, 5 boksa "Marllbora " ne vlere 90 euro, disa pako cigare ne vlere prej 60 euro si dhe para te gatshme ne apoena metalike ne vlere prej 10 euro , me ç'rast i kanë shkaktuar dëme ne vlere te përgjithshme ne vlerë prej 450 euro .

-me çka si bashkryes ka kryer veprën penale te vjedhjes se rëndë në vazhdimësi nga neni 253/1-1-23 të KPK-ës dhe 81 te KPRK-ës.

Gjykata në mbështetje të nenit 3, 34, 36, 38,64 ,66, 253/1-1-23-të KPK-së lidhur me nenin 81 te KPRK-ës, nenit 365 të KPP, te akuzuarit i shqipton :

DENIM ME BURGIM

Dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **7(shtatë) muaj**, i cili dënim do te ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarimit me

dhunë, ne te cilën dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim nga data **23.11.2012 e gjere me dt. 23.02.2013** .

Të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20 ,00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë ,nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike Komunale në Gjakovë, ka ngritë aktakuzën PP-nr.731/12 te dt. 22.02.2013, kundër të akuzuarve B. H., B. Q. dhe B. R. qe te tre nga Gjakova, për shkak se si bashkryes kanë kryer vepra penale te vjedhjes se rendë nga neni 253/1-1-23 te KPK-ës dhe ndaj te pandehurit S. K. nga Gjakova, për shkak te veprës penale pranim i mallrave te vjedhura nga neni 272/1 te KPK-ës .

Me aktvendimet P.nr.155/13 të dt. 08.04.2015, me propozimin e të akuzuarve dhe pajtimin e prokurorit është veçuar procedura penale ndaj te akuzuarit B. Q., komfor nenit 36/1 te KPK-ës dhe ndaj te njëjtit do te zhvillohet shqyrtimi gjyqësor ndaras me numër te ri të lëndës P.nr. 241/15.

Gjykata me dt. 08.04.2015, ndaj të akuzuarit B. Q., ka lëshuar urdhëresë për shpalljen e letërreshtimit meqenëse i njëjti nuk ka marr pjesë në seancat e caktuara e nga st. policor në Gjakovë ,sipas njoftimit me nr.ref.04/1-08-GJ-S-169/15 të dt. 08.04.2015 jemi njoftuar se i njëjti ka dal jashtë shtetit.

Stacioni policor në Gjakovë , duke vepruar sipas letërreshtimi ka shoqëruar të akuzuarin B. Q. në lokalet e gjykatës me dt. 18.01.2017 , i njëjti u procedua dhe për te njëjtin behet tërheqja e letër rreshtimit .

Gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe publikë te mbajtur me të datë 18.01.2017, Prokurori Bajram Kryeziu , lexon aktakuzën PP.nr.731/12 te dt.21.02.2012, deklaroi se me qe i akuzuari B. Q., akuzohet për këto dy vepra që janë kryer në bashkryerje me të akuzuarit B. H. dhe B. R. dhe atë në afat te shkurtë gjegjësisht brenda të njëjtës natë dhe janë te natyrës se njëjtë , të kryera me dashje plotësohen kushtet ligjore nga neni 81 te KPRK-ës, se këto vepra janë kryer ne vazhdimësi ,andaj konsiderojmë dhe bëjmë rikualifikimin dhe duhet te jetë se këto vepra penale janë vepra penale te vjedhjes se rëndë të kryera në bashkryerje nga i akuzuari B. Q. nga neni 253/1-1-23 të KPK-ës e lidhur me nenin 81 te KPRK-ës. Ne fjalën përfundimtare deklaroi se veprimet faktike te akuzuarit te përshkruara ne aktakuzë u dëshmuara se janë te argumentuara dhe te bazuara ne ligj, kjo bazueshmeri rezulton nga vete pranimi i fajësisë nga ana e te akuzuarit B. Q. si dhe provat tjera qe gjenden ne lende dhe qe i mbështesin aktakuzën, andaj i propozon qe i akuzuari B. Q., të shpallet fajtor për shkallen e përgjegjësisë penale, te dënohet dhe te detyrohet ne pagesën e shpenzimeve te procedurës.

I akuzuari B. Q. gjate shqyrtimit gjyqësor deklaroi se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës te rikualifikuar nga ana e prokurorit dhe atë sipas vullnetit te lirë dhe pa presion dhe ne fjalën e tij përfundimtare deklaroi se me pranim e fajësisë jam penduar për veprat e kryera, mirëpo te gjitha këto vepra qe i kam kryer i kam kryer për shkak te gjendjes se rende ekonomike,

premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, kërkohet falje nga të dëmtuarit për demin e shkaktuar, andaj i propozoi gjykatës që duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimit i fajësisë, gjendjen e varfër ekonomike të me shqiptojë një dënim me të butë.

Pasi gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprat penale që i vihen në barrë dhe është bindur se pranimitin e kanë bërë në baza vullnetare si dhe ka konstatuar se pranimiti i fajësisë ka mbështetje edhe në faktet dhe provat që i përmban aktakuza si deklarata e të dëmtuarve M. V. dhe V. M. të dhënë në st. Policor dhe prokurori, përmbajtja e dosjeve të forenzikes FGJ-488 dhe 487, raportet e këqyrjes nga vendi i ngjarjes dhe fotoalbumet dt. 19.11.2012, ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 të KPP, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

Gjykata konstatoi se në veprimet e të akuzuarit, qëndrojnë të gjitha tiparet e veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 253/1-1-23 të KPK-ës, lidhur me nenin 81 të KPRK-së, të cilin fakt e ka vërtetuar nga vetë pranimiti i fajësisë nga ana e i të akuzuarit, e i cili pranimiti i fajësisë ka mbështetje edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjate marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit dhe llojit të tij, Gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rëndueset e parapara në nenin 64 të KPK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimin. Gjykata nuk ka gjetur rrethana posaçërisht rëndueset përpos që ka konstatuar se ndaj të akuzuarit janë duke u zhvilluar procedura penale për vepra penale të vjedhjes së rëndë nga neni 253/1-1-23 të KPK-ës, ku B. Q. është i dënuar me dënim me burgim dhe ndaj të njëjtit janë në rrjedhë disa procedura penale, si rrethana lehtësuese ka marr parasysh sjelljen e mirë të akuzuarit gjate shqyrtimit gjyqësor, gjendjen e varfër ekonomike, moshën relativisht të re në kohën e kryerjes së veprave penale, kohën e kryerjes së veprave penale, shprehja e pendimit dhe premtimi se nuk do të kryej vepra të ngjashme, ka zbatuar dispozitat e zbutjes së dënimin komfor nenit 66/2 të KPK-ës dhe të akuzuarve iu ka shqiptuar dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej **7 (shtatë) muajve**, në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt.28.11.2012 gjere me dt. 23.02.2013, me bindje se ky dënim është në harmoni me peshën e veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale të akuzuarit, personalitetin e të akuzuarit dhe se Gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimin të parapare me nenin 34 të KPK-ës.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marr komfor nenit 463 par. 2 të KPPK-së, pasi që gjykata gjate shqyrtimit gjyqësor nuk ka mundur të saktësojë lartësinë e dëmit që të akuzuarit iu kanë shkaktuar të dëmtuarve pasi që nuk ka asnjë ekspertizë apo konstatim për lartësinë e dëmit të shkaktuar.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr. 241/15 më datë 18.01.2017**

Sekretarja juridike,

Gj y q t a r j a,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** nga dita e marrjes se tij ne dorëzim Gjykatës se Apelit ne Prishtinë.
Gjykatë. Ankesa ne kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj